

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E HËNË 31 TETOR 2022

E nderuar zonja kryesuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Asnjë shqiptar nuk ka sot më dyshime se e ashtuquajtura reformë territoriale dhe administrative e vitit 2014 është ndër masakrat më të mëdha që i është bërë hartës sonë për qëllime të pastra politike. Ndaj, ndërsa sot paraqitet puna e komisionit të posaçëm, në këtë seancë ne duhet të korrigojmë gabimet e së shkuarës. Këta 8 vjet kanë dëshmuar se reforma jo vetëm nuk i ka përmbushur pritshmëritë e saj të vendosura në letër, por është kthyer në një pengesë për mijëra qytetarë çdo ditë të jetës së tyre. Nevoja e riorganizimit të bashkive është një domosdoshmëri absolute. Nuk dua t'i përsërit fjalët e kolegëve të mi opozitarë, por po jap vetëm një shembull të thjeshtë. Krahasojmë Krujën para vitit 2015 me Krujën sot. Kruja sot ka nevojë urgjente që të ndahet në dy bashki, në Bashkinë e Fushë-Krujës dhe në Bashkinë e Krujës. Kjo nuk është një kërkesë e Partisë Demokratike, por është një kërkesë e komunitetit të qytetit, bazuar në historinë, traditën dhe zakonet, që është një nga kriteret kryesore për ndarjen e hartës territoriale.

Ju nuk mundeni kurrsesi të injoroni kulturën dhe të drejtat e komunitetit vendas. Ata e dinë më mirë se kushdo se ku dhe kujt i përkasin dhe nuk mund t'i kushtëzojë kjo pseudoreformë. Nga ana tjetër, edhe prej specialistëve të fushës është nënvizuar se një ndarje e tillë do të ishte e drejtë në procesin e ndarjes së burimeve të disponueshme dhe kapaciteteve në zbatim, gjithashtu, edhe komuniteti të marrë shërbimet e nevojshme dhe të domosdoshme.

Në 8 vjetët e fundit në Krujë nuk ka pasur asnjë investim serioz, që t'i shërbejë zhvillimit të qytetit dhe punësimit të qytetarëve. Dy janë investimet kryesore që janë bërë në qytetin e Krujës: qendra e qytetit të Krujës dhe ujësjellësi. Investimi i parë nuk i shërbeu për asgjë qytetit të Krujës, vetëm i humbi identitetin këtij qyteti dhe i prishi bukurinë natyrore. Ujësjellësi është ende në proces punimi dhe financimi dhe kjo pasqyrohet në buxhetin e vitit 2023. Për këtë investim ne, si opozitë, kemi pasur kundërshtitë tona dhe kemi bërë denoncimet e duhura. Kryeministri, në inaugurimin e këtij ujësjellësi premtoi në fushatë se do të kishte 24 orë ujë, por në të vërtetë ka vetëm dy orë ujë në 24 orë.

Vetëm 36 kilometra larg qytetit, në Krujë, shteti është inekzistent. Të paktat investime, që janë bërë në turizëm, i takojnë iniciativës private. Kruja i ngjan sot panoramës së një qyteti pa jetë, ku, sipas statistikave, 70% e nxënësve, që mbarojnë shkollën e mesme, nuk kthehen më në këtë qytet, sepse nuk është më pikë referimi për ta dhe nuk e shikojnë aty të ardhmen tyre.

Kanë filluar edhe pasojat e tjera, ku bizneset e mëdha janë duke shkuar drejt falimentimit, sepse qyteti është shpopulluar. Gjithashtu, kujtojmë se çdo ditë kemi ulje të numrit të nxënësve dhe, duke e krahasuar me një vit më parë, në 3 shkollat e qytetit janë ulur 110 nxënës pak në këtë shtator. Kruja sot pret në vit rreth 300 mijë vizitorë, të cilët qëndrojnë vetëm disa orë dhe më pas largohen. Ata marrin me vete dashurinë e banorëve, mikpritjen, madhësinë e qytetit, por marrin edhe zhgënjimin, sepse, sapo ngjiten në qytetin e Krujës, gjëja e parë që i zhgënjën është infrastruktura. Në rrugën Krujë – Fushë-Krujë nuk është bërë asnjë lloj investimi. Gjithashtu, sapo hyjnë në qytetin e Krujës ndeshen me pamjen e parë. Shikoni çfarë ka bërë “Rilindja urbane” në qytetin e Krujës! Ja me çfarë ndeshen turistët! Ata ndeshen me një stadium të mbushur me bagëti që kullosin atje. Ngjiten më lart në një kënd sportiv, i cili është inekzistent. Shikojeni, kjo është panorama e Krujës, nuk ka njerëz në qytetin e Krujës!

Gjithashtu, më 6 maj të vitit 2021 qeveria deklaroi: “Me një vlerë investimi prej 490 milionë lekësh, në kuadër të programit “Rilindja urbane”, Bashkia e Krujës është transformuar. Besoj se transformimin e patë. Pasi turistët shikojnë amortizimin e rrugës Fushë-Krujë deri në Krujë, ata nuk hasin as jetë kulturore, as jetë sportive. Me keqardhje konstatoj se edhe tradita e artizanëve po humbet. Nuk ka treg për shitje, nuk ka as strategji të mirëfilltë për ta mbajtur të gjallë këtë pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore kombëtare.

Për të gjitha sa thashë më sipër, si deputete e Krujës, insistoj për ndarjen e re administrative, që përfaqësimi i zërit të qytetarëve në proceset vendimmarrëse të jetë real dhe të dëgjohet për më shumë transparencë, si një mënyrë për shpërndarje të balancuar të të mirave, shërbimeve, si dhe për rigjallërimin e jetës sociale, ekonomike dhe politike, si një strategji për të frenuar shpopullimin. Nuk ka shtet në botë që nuk investon për të ruajtur identitetin e tij. Kruja është qyteti që na identifikon në botë, e cila ndodhet në çdo hartë turistike, që identifikohet me heroin tonë kombëtar Skënderbeun.